



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 3101 Prot

Shkodër, më 09.10.2024

VENDIM

Nr. 211 datë 09.10 2024

Për shfuqizimin e vendimit të Senatit Akademik nr. 160, datë 09. 07. 2024 "Për miratimin e një anëtari zëvendësues të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në USH"

Në zbatim të ligjit 40/ 2015 "Kodi i Procedurave Administrative në RSH", (i ndryshuar), neni 109, gërma d); neni 113; neni 114; neni 117, pika 2; Ligjit 80/ 2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, pika 1; Statutit të USH-së, neni 17, pika 1; Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës", neni 6, pika 1, gërma e); referuar shkresës së Rektorit të USH-së, (Kryetar i Senatit Akademik), me nr. 3046 prot, datë 07. 10. 2024, mbi pretendimet për shkeljet ligjore në emërimin e një anëtari zëvendësues të KIZ, miratuar me vendimin e SA nr. 160, datë 09. 07. 2024; në mbledhjen e tij të datës 09. 10. 2024; me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë, Senati Akademik:

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e Vendimit të Senatit Akademik të USH- së, nr. 160, datë 09. 07. 2024 "Për miratimin e një anëtari zëvendësues të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në USH", për shkak të nxjerrjes së këtij akti në kundërshtim me Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës", neni 6, pika 1, gërma e).
2. Ky vendim i përcillet për dijeni Znj. Merisë Rukaj dhe Komisionit Institucional të Zgjedhjeve në USH.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof.dr. Tomir GJERAJ